



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES SË VEÇANTË

“PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDERTIMIT PËR OBJEKTIN: “FERMË MBARËSHTIMI TË KAFSHËVE TË IMËTA 1 KAT ME MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VORË

MIRATOHET  
KRYETARI I K.K.T.



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISSË

Znj. Belinda Balluku



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 25, Datë 24.11.2021

Projektues:

ATRIA STUDIO Sh.p.k.



## **TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË**

### **1. Dispozita të Përgjithshme**

1.1 Baza Ligjore

1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

### **2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor**

2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së

2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

### **3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese**

### **4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit**

4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave

4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit

4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta / vendparkimet

### **5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës**

5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave




## **1. Dispozita të përgjithshme**

### **1.1 Baza Ligjore**

- Ligj Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores se Planifikimit te Territorit" e ndryshuar;
- VKM 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", e ndryshuar – VKM Nr. 1096 datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike";

### **1.2 Përshkrimi i zonës së studiuar**

Territori në këtë studim pozicionohet në veri të qytetit të Vorës, në fshatin Ahmetaq, Bashkia Vorë në një zonë me funksion kryesish bujqësore. Ndërhyrja në këtë territor synon plotësimin e kësaj hapësire nga pikëpamja funksionale. Gjatë hartimit të këtij projekti është marrë parasysh respektimi i situatës ekzistuese të zonës. Propozohet ndërtimi i 12 strukturave 1 kat me funksion stalla për kafshët.



1. Pozicioni i zonës së studiuar

A handwritten signature in black ink, likely belonging to the author or a representative.


### **2. Ekstrakte të Planit të Përgjithshëm Vendor**

#### **2.1 Përputhshmëria me kategorinë e përdorimit të tokës sipas PPV-së**


Duke u bazuar në Rregulloren Vendore të Bashkisë Vorë, të miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3, datë 17.05.2019, "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vorë", për zonën e interesit VO\_B\_B2\_1-131 janë vlerësuar dhe respektuar të gjitha kategoritë e përdorimit të tokës që propozon plani.

## 2.2 Seti i fragmenteve të hartave të PPV për zonën në zhvillim

Më poshtë paraqiten hartat nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vorë, në të cilat mendohet se propozimi i projektit: "FERMË MBARËSHTIMI TË KAFSHËVE TË IMËTA 1 KAT ME MUR RRETHUES", Bashkia Vorë, me zhvillues IMPULS sh.p.k., do të jetë funksional dhe në përpunje me kërkesat e zhvillimit të zones në të ardhmen.



## 2. Ndarja e territorit në zona dhe njësi



### *3. Harta e propozuar e kategorive të përdorimit të tokës*



#### 4. Pasaporta e nënnjësisë

|                 |               |
|-----------------|---------------|
| Bashkia         | Vorë          |
| Njësie          | VO_B_B2_1-131 |
| Sistemi         | B_Bujqësore   |
| Lartësia (Kate) | 2             |
| Lartesa (Metra) | 6.5           |
| PDV             | JO            |

#### 3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese

Objekti i projektuar do të zhvillohet në zonën kadastrale 1006, në pasuritë me nr. 163/4, 163/5, 163/30. Kjo zonë pozicionohet në veri të qytetit të Vorës, në fshatin Ahmetaq, ku parashikohet zhvillimi i brendshëm i zonës me struktura të reja deri në 2 kate, sipas përcaktimit të PPV. Aktualisht në këto prona nuk ka objekte të ndërtuara.



#### 4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

##### 4.1 Funksionet dhe aktivitetet e propozuara

Kompleksi i stallave do të aksesohet nga pjesa jugore e tij. Studimi parashikon 12 ndërtesa me lartësi 1 kat. Sheshi i ndërtimit rrrethohet me rrugë në pjesën veriore dhe jugore të tij. Objektet me funksion stalla janë të shpërndara në të gjithë sheshin duke ruajtur distancat dhe duke mundësuar qarkullimin e lirë të mjeteve dhe personave në shesh.

Kategoritë e propozuara janë si më poshtë;

| Kod | Sist            | Nr. | Kod | Kategori          | Nr. | Kod | Nënkategori                         | Nr. | Kod     | Funksion         |
|-----|-----------------|-----|-----|-------------------|-----|-----|-------------------------------------|-----|---------|------------------|
| IN  | Infrastrukturor | 1   | T   | Transporti        | 7   | 1   | Rrugore                             | 135 | INT 1-6 | Rrugë Lokale (F) |
| B   | Bujqësor        | 18  | EB  | Ekonomi Bujqësore | 47  | EB2 | Struktura në funksion të Blegtorisë | 207 | EB1-4   | Fermë            |
|     |                 |     |     |                   |     |     |                                     | 208 | EB2-1   | Stalla           |
|     |                 |     |     |                   |     |     |                                     | 212 | EB2-5   | Baxho            |

##### 4.2 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Rifiniturave

Ndërhyrjet në fasadë pas përfundimit të punimeve duhen të marrin në konsideratë:

Përdorimit të njëjtave materiale për trajtimin dhe/ose veshjen e fasadës.

Vendosjen e kontrolluar të tendave dhe hijëzuesve të tjerë të çfarëdo lloji, të paparashikuar në projektin e miratuar të strukturës;

Vendosjen e kontrolluar të tabelave të reklameve;

Ndërtesa është e zgjidhur në mënyrë të thjeshtë dhe racionale duke iu përbajtur normave bazë të projektimit dhe duke propozuar zgjidhje të qëndrueshme funksionale dhe estetike.

Fasadat janë të thjeshta estetikisht, qëllimi qëndron në paraqitjen e një uniteti të mirë kompozicional, duke realizuar volume të pastra që i përgjigjen më së miri funksioneve të objektjeve.

Ky volum harmonizohet mirë me kontekstin rrethues të zonës me anë të pastërtisë së zgjidhjes së tij dhe materialeve të përdorura.

#### **4.3 Përcaktimin e treguesve për zhvillim të projekt-propozimit**

Treguesit teknik janë si më poshtë:

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| Sipërfaqja e përgjithshme e truallit                              | <b>16000 m<sup>2</sup></b>  |
| Sipërfaqja e truallit që përdoret për zhvillim                    | <b>16000 m<sup>2</sup></b>  |
| Sipërfaqja e truailit e zënë nga struktura e propozuar            | <b>7434.8 m<sup>2</sup></b> |
| Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit (mbi tokë)                  | <b>7434.8 m<sup>2</sup></b> |
| Koeficienti i shfrytëzimit  | <b>46.46 %</b>              |
| Intensiteti i ndërtimit   | <b>0.46</b>                 |
| Lartësia maksimale e strukturës nga niveli i kuotës së sistemimit | <b>6.19 m</b>               |
| Numri i kateve mbi tokë   | <b>1 kat</b>                |
| Numri i kateve nën tokë   | <b>0 kat</b>                |



#### **Distancat nga kufiri i pronës:**

##### **Objekti A**

|           |             |                                       |
|-----------|-------------|---------------------------------------|
| Veri :    | 3.9 – 5.1 m | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
| Perëndim: | 6 – 11.4 m  | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |

##### **Objekti B**

|        |             |                                       |
|--------|-------------|---------------------------------------|
| Veri : | 5.4 – 8.6 m | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
|--------|-------------|---------------------------------------|

##### **Objekti C**

|              |              |                                       |
|--------------|--------------|---------------------------------------|
| Veri :       | 4.6 – 5 m    | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
| Veri-Lindje: | 11.6 m       | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
| Lindje:      | 6.6 – 14.1 m | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |

##### **Objekti D**

|           |              |                                       |
|-----------|--------------|---------------------------------------|
| Jug :     | 5 m          | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
| Perëndim: | 3.9 – 10.5 m | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |

##### **Objekti E**

|       |     |                                       |
|-------|-----|---------------------------------------|
| Jug : | 5 m | nga kufiri i pronës për volumin 1 kat |
|-------|-----|---------------------------------------|

## Objekti I

Jug : 5 m nga kufiri i pronës për volumin 1 kat

## Objekti J

Jug : 5 m nga kufiri i pronës për volumin 1 kat

## Objekti K

Jug : 5 m nga kufiri i pronës për volumin 1 kat

Lindje: 6.4 – 13.8 m nga kufiri i pronës për volumin 1 kat

Treguesit teknik janë si më poshtë:

| Objektet  | Funkioni   | Kuota           | Siperfaqe (m <sup>2</sup> ) |
|-----------|------------|-----------------|-----------------------------|
| Objekti A | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 556.3 m <sup>2</sup>        |
| Objekti B | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 1377 m <sup>2</sup>         |
| Objekti C | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 1575.8 m <sup>2</sup>       |
| Objekti D | veterinari | ±0.00           | 238.5 m <sup>2</sup>        |
| Objekti E | hambar     |                 | 1240 m <sup>2</sup>         |
| Objekti F | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 261.1 m <sup>2</sup>        |
| Objekti G | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 517.1 m <sup>2</sup>        |
| Objekti H | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 517.1 m <sup>2</sup>        |
| Objekti I | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 454.9 m <sup>2</sup>        |
| Objekti J | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 900.9 m <sup>2</sup>        |
| Objekti K | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 900.9 m <sup>2</sup>        |
| Objekti L | stallë     | ±0.00 dhe -0.05 | 135.2 m <sup>2</sup>        |



| Emërtime                          | Siperfaqe (m <sup>2</sup> ) |
|-----------------------------------|-----------------------------|
| Sipërfaqe ndërtimi nën tokë       | 0 m <sup>2</sup>            |
| Sipërfaqe ndërtimi mbi tokë       | 7434.8 m <sup>2</sup>       |
| Sipërfaqe stallë                  | 7196.3 m <sup>2</sup>       |
| Sipërfaqe veterinarie             | 238.5 m <sup>2</sup>        |
| Sipërfaqe strukture e çmontueshme | 1240 m <sup>2</sup>         |

| Tregues te tjerë                     |            |
|--------------------------------------|------------|
| Koefficienti i shfrytëzimit të tokës | k = 46.46% |

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Intensiteti i ndërtimit</b>            | i = 0.46      |
| <b>Hyrja kryesore në godinë</b>           | Veri-Perëndim |
| <b>Lartësia e përgjithshme e objektit</b> | 6.19 m        |
| <b>Numri i kateve mbi tokë</b>            | 1 kat         |
| <b>Numri i kateve nën tokë</b>            | 0 kat         |



#### 4.4 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Hapësirat e lira ndërmjet ndërtesave duhet të parashikojnë:

- Vendosjen e ndriçimit;
- Nevojat e personave me aftesi të kufizuara;
- Pajisjen me elemente të ndryshme të mobilimit urban si; stola, vend-depozitime të mbeturinave, etj;
- Gjelbërimi i këtyre hapësirave me pemë, shkurre e bimë dekorative;
- Pajisjen me vendqëndrime bicikletash.

### 5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

#### 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

##### *Infrastrukturat rrugore*

Gjatë hartimit të projektit duhet të respektohen të gjitha parashikimet e Kodit Rrugor të Republikës se Shqipërisë si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në rastet e ndërprerjes së trotuareve të parashikohet ndërtimi i rampave të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftesi të kufizuar.

##### *Infrastrukturat e ujësjellësit*

Pozicionimi i infrastrukturës dhe teknologja duhet t'i përgjigjen kërkesave bashkëkohore të projektimit të tyre.

Sistemet e shtrimit të linjave të rrjetit duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme dhe të aksesueshme, duke përbushur parametrat teknike përkatëse, me mundësi kontrolli, mirëmbajtjeje dhe riparimi, pa qenë e nevojshme të bëhen ndërhyrje nga sipërfaqja.

##### *Infrastrukturat KUZ / KUB*

Pozicionimi i infrastrukturës dhe teknologja duhet t'i përgjigjen kërkesave bashkëkohore të projektimit të tyre. MUSH do të riciklohen për nevojat e plehërimit të tokës në ndihmë të bujqësisë.

### *Infrastrukturat energjetike*

Infrastruktura energjetike rekomandohet të asistohet nga përdorimi i sistemeve de shfrytëzojnë energjinë diellore për prodhimin e energjisë elektrike apo për ngrohjen e ujit sanitar. Këto sisteme mund të aplikohen në nivel ndërtese dhe kanë për qellim reduktimin e nevojave dhe konsumit të energjisë.

